



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 568/7 prot.

Datë 29.04.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 410/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-16646-12-29-2021, me objekt: Loti 1 “*Blerje bukë gruri dhe simite*”, me fond limit 168.101.564 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK  
Lagja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iljaz Ahmeti”, pranë Fabrikës së Qumështit, Lushnje

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK  
Njësia bashkiake Nr.2, Rruga “Ali Shefqeti”, banese private nr 17, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.12.2021, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-16646-12-29-2021, me objekt: Loti 1 “Blerje bukë gruri dhe simite”, me fond limit 168.101.564 lekë (pa

tvsh), zhvilluar me datë 11.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 11.02.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 03.03.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK  
139.726.733 lekë, kualifikuar
2. “Sinani Trading” SHPK  
150.627.925 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 08.03.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 17.03.2022 operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK, ka paraqitur njëkohësisht ankesë pranë autoriteti kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.568/2 prot., datë 18.03.2022 lidhur me kriteret për të cilat ky i fundit pretendon se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK, të kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 539 prot., datë 30.03.2022, protokolluar me tonën me nr. 568/5 prot., datë 31.03.2022 me objekt “*Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 “Blerje bukë gruri dhe simite”, si dhe shkresës me nr. 536/1 prot., datë 31.03.2022, protokolluar me tonën me nr. 568/6 prot., datë 04.04.2022 me objekt “Dërgim informacion në lidhje me shkresat me nr.568 prot., datë 25.03.2022”* është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Sinani Trading” SHPK dhe me shkresën nr. 459/3 prot., datë 30.03.2022, ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues mbi Vendimin nr.459/2

prot., datë 29.03.2022 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II.9. Në datën 25.03.2022 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK, si subjekt i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka dorëzuar pranë KPP formularin e paraqitjes së argumenteve në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimes “Sinani Trading” SHPK, por nga shqyrtimi i kushteve formale të këtij formulari, konstatohet se ky i fundit nuk është paraqitur brenda afateve ligjore, të parashikuara në nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK me arsyetimin se “Në lidhje me kërkesën si më sipër operatori “Eraldo” dhe “Dion Al” shpk për mjetet të cilat i disponon kundrejt qerasë nuk janë të llojit ATP, nuk janë të deklaruara në ekstraktin e QKB si dhe afati i kontratave të qerasese nuk mbulon periudhën 2 vjecare të marrëveshjes kuadër”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “SHTOJCË NR. 1, DATË 17.01.2022”, për Lotin 1, pika 2.3.3 e Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, është modifikuar si më poshtë:

#### **ISHTE**

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 6 (gjashtë) automjete ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira. Per sa me sipër operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i mjetit</b>	<b>Targa</b>	<b>Kapaciteti mbajtes</b>	<b>Statusi</b>
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim
3				Pronesi/qira/perdorim
4				Pronesi/qira/perdorim
5				Pronesi/qira/perdorim

6				Pronesi/qira/perdorim
---	--	--	--	-----------------------

**Shenim:**

*Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.*

*Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikaten per transportin e lendeve te rrezikshme dhe pashaporten e mjetit per kapacitetin mbajtes ne litra.*

**Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

**BËHET:**

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 6 (gjashtë) automjete ATP (jo frigorifer), per transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i mjetit</b>	<b>Targa</b>	<b>Kapaciteti mbajtes</b>	<b>Statusi</b>
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim
3				Pronesi/qira/perdorim
4				Pronesi/qira/perdorim
5				Pronesi/qira/perdorim
6				Pronesi/qira/perdorim

**Shenim:**

*Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.*

*Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.*

**Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Dokumenti “Kontratë bashkëpunimi”, datë 10.02.2022, ndërmjet operatorëve ekonomikë “Eraldo – 2013” SHPK dhe “Dion – Al” SHPK.

Në këtë kontratë bashkëpunimi në nenin 4 të saj pika 1 “Pjesëmarrja”, është përcaktuar se:

1. Pjesëmarrja e shoqërive e shprehur në përqindje në arritjen e objektit të kësaj kontrate do të jenë si më poshtë:

*Loti 1: “Blerje bukë gruri dhe simite”*

*Shoqëria “Dion –AL’SHPK do të ketë një pjesëmarrje prej 64 % (64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 64 % të sasisë totale Simite).*

*Shoqëria “Eraldo – 2013” SHPK të ketë një pjesëmarrje prej 36 % (36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 36 % të sasisë totale Simite).*

#### **Operatori ekonomik “Eraldo – 2013” SHPK**

- Deklaratë ”Mbi disponimin e makinerive” e operatorit ekonomik ”Eraldo – 2013” SHPK
  
- Kontratë Qeraje Nr.7733 rep., Nr. 2694 kol., datë 18.12.2021, për marrjen me qera të mjeteve Kamion, me targë AA307YJ dhe Kamion me targë AA814YM, ndërmjet qeradhënësit shoqëria ”Besniku” dhe qeramarrësit shoqëria ” Eraldo – 2013” SHPK
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA814YM
  - Leje qarkullimi;
  - Certifikatë e kontrollit teknik;
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit;
  - Certifikatë nr. 03 datë 04.03.2020 ”Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Shijak;
  - Akt – Miratimi Higjeno – Sanitar nr. 276, datë 05.03.2020, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor;
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA307YJ
  - Leje qarkullimi;
  - Certifikatë e kontrollit teknik;
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit;
  - Certifikatë nr. 05 datë 04.03.2020 ”Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Shijak;
  - Akt - Miratimi Higjeno – Sanitar nr. 37, datë 07.05.2020, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor;
  
- Kontratë Qeraje Nr.10872 rep., Nr. 3577 kol., datë 17.12.2021, për marrjen me qera të mjeteve Kamion, me targë AA702OZ dhe Kamion me targë AA109XI, ndërmjet qeradhënësit shoqëria ”Miell Tirana” dhe qeramarrësit shoqëria ”Eraldo – 2013” SHPK
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA702OZ
  - Leje qarkullimi;
  - Certifikatë e kontrollit teknik;
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit;
  - Certifikatë nr. 31601 datë 15.10.2018 ”Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet”, lëshuar nga Bashkia Tiranë;
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA109XI
  - Leje qarkullimi
  - Certifikatë e kontrollit teknik

- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit
- Certifikatë nr. 11654 datë 12.03.2019 "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet", lëshuar nga Bashkia Shijak
- Akt - Miratimi Higjeno – Sanitar nr. 146, datë 23.05.2019, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor

#### **Operatori ekonomik "Dion - AL" SHPK**

- Deklaratë "Mbi disponimin e makinerive" e operatorit ekonomik "Eraldo – 2013" SHPK
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë TR 4361 U, në emër të shoqërisë "Shpresa" SHPK
  - Leje qarkullimi;
  - Certifikatë e kontrollit teknik;
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit;
  - Akt - Miratimi Higjeno – Sanitar nr. 1782, datë 23.09.2016, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor
- Kontratë Qeraje Nr.1289 rep., Nr. 358 kol., datë 11.02.2022, për marrjen me qera të mjetit ATP me targë AA451JJ, ndërmjet qeradhënësit shoqëria "Eraldo" SHPK dhe qeramarrësit shoqëria "Dion - Al" SHPK
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA702OZ
  - Leje qarkullimi;
  - Certifikatë e kontrollit teknik;
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit;
  - Certifikatë nr. 31601 datë 15.10.2018 "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet", lëshuar nga Bashkia Tiranë;
- Kontratë Qeraje Nr.1288 rep., Nr. 357 kol., datë 11.02.2022, për marrjen me qera të mjetit ATP me targë AB407CC, ndërmjet qeradhënësit z.Fiqiri Karreci dhe qeramarrësit shoqëria "Dion - Al" SHPK
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AB407CC
  - Leje qarkullimi;
  - Certifikatë e kontrollit teknik;
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit;
- Kontratë Qeraje Nr.1290 rep., Nr. 355 kol., datë 11.02.2022, për marrjen me qera të mjetit ATP me targë TR6253M, ndërmjet qeradhënësit Z.Fatjon Tusha dhe qeramarrësit shoqëria "Dion - Al" SHPK
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë TR6253M
  - Leje qarkullimi;
  - Certifikatë e kontrollit teknik;
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit;

III.1.3. Në nenin 14, "Operatorët ekonomikë", pika 2 e Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet: "Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të

*paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.*

Ndërsa në nenin 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*“1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

*2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.*

*5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

*6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të*



*bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.”*

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *I.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.1.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.1.6. Në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 54, pika 1/c, parashikohet:

*“c) automjetet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtusit të mjetit;”*

*Ndërsa në pikën 2 të po këtij neni parashikohet: “Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta.”*

III.1.7. Në Rekomandimin Nr.10181 prot., datë 19.11.2018 dhe nr.8514 prot., datë 19.11.2018 midis Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit me objekt “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” në paragrafin III “Hartimi i kritereve të Veçanta për Kualifikim”, pika “e” përcakton :

*“Në hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që :*

[...]

*e. Operatori të ketë në pronësi ose në përdorim, automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportimin e mallrave, automjet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportimin e mallrave, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe që plotësojnë kushtet higjieno sanitare.*

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm me anë të të cilit të vërtetojnë se disponojë **të paktën 6 (gjashtë)** automjete ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e furnizimit të marrë përsipër. Në rastin konkret referuar dokumentit kontratë bashkëpunimi, konstatohet se pjesëmarrja e këtyre operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi do të jetë *Shoqëria "Dion – AL'SHPK do të ketë një pjesëmarrje prej 64 % (64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 64 % të sasisë totale Simite), dhe Shoqëria "Eraldo – 2013" SHPK të ketë një pjesëmarrje prej 36 % (36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 36 % të sasisë totale Simite).*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Eraldo - 2013" SHPK & "Dion – AL" SHPK, në përmbushje të kriterit për disponimin e mjeteve, rezulton se, operatori ekonomik "Eraldo - 2013" SHPK, si një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ka paraqitur dokumentacionin ku vërteton se disponon me anë të kontratës së qirasë 4 mjete (konkretisht mjetet me targë AA307YJ, AA814YM, AA702OZ, AA109XI), si dhe dokumentacionin përkatës për këto mjete (kontratat e qirasë, certifikatat e pronësisë, leje qarkullimi të mjeteve përkatëse, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni etj). Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik "Eraldo - 2013" SHPK, si një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të kriterit për disponimin e mjeteve të llojit ATP në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së tij në këtë bashkim, konkretisht, për mjetet me targa AA307YJ, AA814YM, AA702OZ, AA109XI, referuar lejes së qarkullimit të secilit mjet, rezulton se, për secilin prej tyre në lejen e qarkullimit përcaktohet lloji i mjetit "Kamion" dhe jo "ATP" siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentat e tenderit. Pra, asnjë nga mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik "Eraldo – 2013" SHPK, si një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë,

nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor që të jenë të llojit ATP (automjet për transport të përzier).

Sqarojmë se, referuar legjislacionit të fushës përkatëse, si më sipër cituar, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, në nenin 54, pika 1/c të tij parashikohet se në automjetet për transport të përzier përfshihen mjetet të cilat kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë [...]. Si rrjedhim në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri që duhet të paraqitet dokumentacion për mjetet të llojit ATP, që në kuptim të legjislacionit në fuqi për qarkullimin rrugor këto mjete nuk duhet të tejkalojnë kapacitetin maksimal 3.5 ton, konstatojmë se, nga verifikimi i dokumentit leje qarkullimi të dorëzuar për këto mjete, përcaktohet lloji i tyre “Kamion” dhe peshë të përgjithshme më të madh se 3.5 ton.

Në përfundim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar shprehimisht kriteri që, duhet të paraqitet dokumentacioni i nevojshëm për 6 mjete ATP, konstatojmë se operatori ekonomik “Eraldo-2013” SHPK, si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë, nuk ka arritur të vërtetojë se disponon mjete të tilla, në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, duke mos e plotësuar kështu kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Rrjedhimisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues me dokumentacionin e paraqitur nuk provon plotësimin e kriterit në lidhje me disponimin e mjeteve.

Akoma më tej, referuar Rekomandimit Nr.10181 prot., datë 19.11.2018 dhe nr.8514 prot., datë 19.11.2018 midis Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit me objekt *“Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”* përcaktohet se në hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që *“Operatori të ketë në pronësi ose në përdorim, automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportimin e mallrave, automjet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportimin e mallrave, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe që plotësojnë kushtet higjieno sanitare.”*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK me arsyetimin se *“Në lidhje me kërkesën si më sipër BOE “Eraldo-2013” shpk & “Dion – Al” nuk plotëson kërkesën për punë të ngjashme me objektin e këtij prokurimi në përputhje me përqindjen e punës së marrë përsipër nga secili operator sipas kontratës së bashkëpunimit. Operatori Eraldo 2013 ka paraqitur fatura tatimore shitje të cilat nuk arrijnë vlerën prej 40 % të fondit limit. Faturat e paraqitura prej këtij operatori nuk janë të ngjashme me objektin e këtij prokurimi pasi në pjesën më të madhe përmbajnë artikuj të tjerë si ëmbëlsira, bulmet, mish, ujë etj. Po ashtu faturat e paraqitura prej këtij operatori nuk janë të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi pasi nuk janë të shoqëruara në raportin e kasës fiskale. Nga ana tjetër faturat e paraqitura prej këtij operatori për vitin 2022 janë të pavlefshëm pasi kushti kualifikues është i tillë që pranohen dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data shpalljes së njoftimit të*

kontratës, çka do të thotë se pranohen furnizime të ngjashme të 3 viteve të fundit duke filluar nga data 30.12.2021.

Operatori Dion – AL po ashtu nuk plotëson punët e ngjashme sipas përqindjes së punës të marrë përsipër në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit. Dëshmitë e paraqitura prej kësaj shoqërie nuk janë të ngjashme me objektin e këtij prokurimi si dhe nuk janë të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7, për Loti 1 “Blerje bukë gruri dhe simite”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.2.2. Në shtojcën 6, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, për Loti 1 “Blerje bukë gruri dhe simite”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**Loti 1 " Blerje bukë gruri dhe simite "**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>BUKË GRURI DHE SIMITE- Tabela e Pergjithshme</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikujve ushqimorë</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Sasi të pritshme</b>
2	Bukë gruri me rreze 75%	Kg	1900350
3	Bukë gruri me rreze 70%	Kg	42720
4	Simite me rreze 75% (200 gr)	Copë	2000

<b>BUKË GRURI DHE SIMITE - Instituti I nxënësve që nuk dëgjojnë</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikujve ushqimorë</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Sasi të pritshme</b>
2	Bukë gruri me rreze 75%	Kg	6000
4	Simite me rreze 75% (200 gr)	Copë	2000

<b>BUKË GRURI DHE SIMITE- NjVKSH Shkoder</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikujve ushqimorë</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Sasitë e pritshme</b>
3	Bukë gruri me rreze 70%	Kg	39420

<b>BUKË GRURI DHE SIMITE- NjVKSH KORÇË</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikujve ushqimorë</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Sasitë e pritshme</b>
3	Bukë gruri me rreze 70%	Kg	3300

<b>BUKË GRURI DHE SIMITE- DPB</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i artikujve ushqimorë</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Sasitë e pritshme</b>
2	Bukë gruri me rreze 75%	Kg	1,894,350.00

**Afatet e lëvrimit:** Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, por në çdo rast jo me herët se 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK & “Dion – Al” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Dokumenti “Kontratë bashkëpunimi”, datë 10.02.2022, ndërmjet operatorëve ekonomikë “Eraldo – 2013” SHPK dhe “Dion – Al” SHPK.

Në këtë kontratë bashkëpunimi në nenin 4 të saj pika 1 “Pjesëmarrja”, është përcaktuar se:

2. Pjesëmarrja e shoqërive e shprehur në përqindje në arritjen e objektit të kësaj kontrate do të jenë si më poshtë:

*Loti 1: “Blerje bukë gruri dhe simite”*

*Shoqëria “Dion –AL’SHPK do të ketë një pjesëmarrje prej 64 % (64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 64 % të sasisë totale Simite).*

*Shoqëria “Eraldo – 2013” SHPK të ketë një pjesëmarrje prej 36 % (36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 36 % të sasisë totale Simite).*

#### **Operatori ekonomik “Dion - AL” SHPK**

- Fatura Tatimore Shitje nr.05, datë 30.06.2020, nr.04, datë 27.06.2020; nr.03, datë 27.06.2020; nr.02, datë 13.06.2020; nr.01, datë 06.06.2020; nr.10, datë 31.07.2020; nr.09, datë 26.07.2020; nr.08, datë 19.07.2020; nr.07, datë 12.07.2020; nr.06, datë 05.07.2020; nr.14, datë 31.08.2020; nr.13, datë 25.08.2020; nr.12, datë 16.08.2020; nr.11, datë 08.08.2020; nr.19, datë 30.09.2020; nr.18, datë 27.09.2020; nr.17, datë

20.09.2020; nr.16, datë 13.09.2020; nr.15, datë 06.09.2020; nr.24, datë 01.11.2020; nr.25, datë 07.11.2020; nr. 26 datë 14.11.2020; nr.27, datë 21.11.2020; nr.28 datë 28.11.2020; nr.29 datë 30.11.2020; nr.23 datë 31.10.2020; nr.22 datë 24.10.2020; nr.21 datë 17.10.2020; nr.20 datë 10.10.2020, me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Klient shitje me pakicë me kasë” dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Shitje me pakicë shih bashkëngjitur”;

- Fatura Tatimore Shitje nga data 01.04.2019 deri në 13.10.2019 me shitës “Shpresa” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kasë prodhime brumi” dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Sipas faturës lidhur”;
- Fatura Tatimore Shitje nga data 15.10.2019 deri në 31.12.2020 me shitës “Dion-AL” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kasë prodhime brumi” dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Sipas faturës lidhur”;
- Fatura Tatimore Shitje nga data 12.01.2020 deri në 31.03.2020 me shitës “Dion-AL” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kasë prodhime brumi” dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Sipas faturës lidhur”;
- ❖ Bashkëlidhur faturave të mësipërme operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK ka paraqitur Dokumentin me përmbajtje: Dion –AL shpk; K67917301H; “Pasqyra e shitjeve në njësinë e furrës së bukës (shitje me pakicë me kasë fiskale)”; Buka 1; në të cilën pasqyrohen në tabelë: Nr.; Nr. i serisë së faturës; Data e faturës; Subjekti i cili është përcaktuar “Shitje kase”, Rrethi Tiranë; Totali; Vlera pa tvsh; tvsh.

.....

- Fatura Tatimore Shitje nr.30 datë 05.12.2020; nr.31 datë 12.12.2020; nr.32 datë 19.12.2020; nr.33 datë 26.12.2020; nr.34 datë 31.12.2020; me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Klient shitje me pakicë me kasë” dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Shitje me pakicë shih bashkëngjitur”;

- ❖ Bashkëlidhur faturave të mësipërme operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK ka paraqitur Dokumentin me përmbajtje: Dion –AL shpk; K67917301H; “Pasqyra e shitjeve në njësinë e furrës së bukës (shitje me pakicë me kasë fiskale)”; në të cilën pasqyrohen në tabelë: Nr.; Nr. i serisë së faturës; Data e faturës; Subjekti i cili është përcaktuar “Shitje kase”, Rrethi Tiranë; Totali; Vlera pa tvsh; tvsh.

.....

- Fatura Tatimore Shitje nga data 09.01.2021 deri në 30.11.2021 me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Klient shitje me pakicë me kasë” dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Shitje me pakicë shih bashkëngjitur”;

- ❖ Bashkëlidhur faturave të mësipërme operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK ka paraqitur Dokumentin me përmbajtje: Dion –AL shpk; K67917301H; “Pasqyra e shitjeve në njësinë e furrës së bukës (shitje me pakicë me kasë fiskale)”; në të cilën pasqyrohen në tabelë: Nr.; Nr. i serisë së faturës; Data e faturës; Subjekti i cili është përcaktuar “Shitje kase”, Rrethi Tiranë; Totali; Vlera pa tvsh; tvsh.

.....

- Fatura Tatimore Shitje nr.\_\_\_\_, datë 31.12.2019, me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Dion - AL” SHPK, “Autofaturë”, dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Bukë masive”, me vlerë 460.000 lekë pa tvsh;

- Fatura Tatimore Shitje nr.\_\_\_\_, datë 30.04.2020, me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Dion - Al” SHPK, “Autofaturim”, dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Bukë e zezë masive”, me vlerë 1.571.033 lekë pa tvsh;
- Fatura Tatimore Shitje nr.135, datë 30.04.2020, me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Dion - Al” SHPK, “Autofaturë”, dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “1. Bukë masive; 2. Simitë”, me vlerë 1.137.962,5 lekë pa tvsh;
- Fatura Tatimore Shitje nr.\_\_\_\_, datë 30.11.2019, me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Dion - Al” SHPK, “Autofaturë”, dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “1. Bukë gruri, 2. Sanduic, 3. Simitë”, me vlerë 480.930 lekë pa tvsh;
- Fatura Tatimore Shitje nr.34, datë 30.09.2019, me shitës “Shpresa” sh.p.k. dhe Blerës “Autofaturë”, dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “1. Bukë e bardhë masive, 2. Simitë”, me vlerë 1.576.302,8 lekë pa tvsh;
- Fatura Tatimore Shitje nr.\_\_\_\_, datë 30.06.2019, me shitës “Shpresa” sh.p.k. dhe Blerës “Shpresa” SHPK, “Autofaturë”, dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “1. Bukë masive, 2. Simitë”, me vlerë 1.826.710 lekë pa tvsh;
- Fatura Tatimore Shitje nr.\_\_\_\_, datë 28.02.2019, me shitës “Shpresa” sh.p.k. dhe Blerës “Shpresa” SHPK “Autofaturë”, dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Simitë”, me vlerë 280.000 lekë pa tvsh;

### **Operatori ekonomik “Eraldo – 2013” SHPK**

#### **Viti 2019**

- Fatura Tatimore Shitje nr.16, datë 30.01.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “MC Catering” për produktet Mish; Bukë integrale; Bukë thekre; Bukë masive;
- Fatura Tatimore Shitje nr.2, datë 31.01.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Janar 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.2 datë 31.01.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Janar 2019;
- Fatura Tatimore Shitje nr.11, datë 28.02.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “MC Catering” për produktet Mish viçi, Bukë gruri;
- Fatura Tatimore Shitje nr.3, datë 28.02.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Shkurt 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.2 datë 28.02.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Shkurt 2019;
- Fatura Tatimore Shitje nr.6, datë 31.03.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “MC Catering” për produktet Bukë
- Fatura Tatimore Shitje nr.\_\_\_\_, datë 31.03.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Mars 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.7 datë 31.03.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Mars 2019;

- Fatura Tatimore Shitje nr.12, datë 30.04.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “MC Catering” për produktet Bukë
- Fatura Tatimore Shitje nr.9, datë 30.04.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Prill 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.9 datë 30.04.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Prill 2019;
- Fatura Tatimore Shitje nr.13, datë 31.05.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “MC Catering” për produktet Bukë, Mish
- Fatura Tatimore Shitje nr.15, datë 31.05.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Maj 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.15 datë 31.05.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Maj 2019;
- Fatura Tatimore Shitje nr.25, datë 28.03.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “MC Catering” për produktet Torta, Buke
- Fatura Tatimore Shitje nr.30, datë 28.06.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Olsjan Qordja”, me përshkrim “Sipas kuponit bashkangjitur” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur Kuponi tatimor;
- Fatura Tatimore Shitje nr.16, datë 30.06.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Qershor 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.16 datë 30.06.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Qershor 2019;
- Fatura Tatimore Shitje nr.28, datë 31.07.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Eglent” për produktet Torta, Buke
- Fatura Tatimore Shitje nr.27, datë 31.07.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “MC Catering”, me përshkrim Mish vici, Buke
- Fatura Tatimore Shitje nr.19, datë 31.07.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Korrik 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.19 datë 31.07.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Korrik 2019;
- Fatura Tatimore Shitje nr.29, datë 31.08.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Eglent” për produktet Torta, Buke
- Fatura Tatimore Shitje nr.21, datë 31.08.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Gusht 2019” dhe bashkëlidhur kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.21 datë 31.08.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Gusht 2019;
- Fatura Tatimore Shitje nr.32, datë 30.09.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Eglent” për produktet Torta, Buke
- Fatura Tatimore Shitje nr.22, datë 30.09.2019, me shitës “Eraldo-2013” sh.p.k. dhe Blerës “Shitje me kase”, me përshkrim “Xhiro kase Shtator 2019” dhe bashkëlidhur



kësaj fature është paraqitur dokumenti Faturë Shitje nr.22 datë 30.09.2019 në të cilin listohen të gjitha produktet e shitura, si dhe Libri i shitjeve të shoqërisë Eraldo – 2013 për muajin Shtator 2019;

## **Viti 2020**

Për muajt Janar – Nëntor 2020 operatori ekonomik “Eraldo-2013” SHPK ka paraqitur:

- Librin e shitjeve të kësaj shoqërie për secilin nga muajt e mësipërm;
- Fatura shitje për secilin muaj për “Shitje me kasë kupona – Furra”, në të cilin listohen produktet e shitura për secilin muaj;
- Xhiro ditore e kasës
- Kupona tatimore

- .....
- Fatura Tatimore Shitje nr.29, datë 31.01.2020; nr.22, datë 09.03.2020; nr.24, datë 30.04.2020; nr.26, datë 30.07.2020; nr.46, datë 24.10.2020; nr.2, datë 09.03.2020; nr.3, datë 03.10.2020; nr.48, datë 10.10.2020; nr.40, datë 30.11.2020;

## **Viti 2021**

Për muajt Janar – Gusht 2021 operatori ekonomik “Eraldo – 2013” SHPK ka paraqitur:

- Librin e shitjeve të kësaj shoqërie për secilin nga muajt e mësipërm;
- Fatura shitje për secilin muaj për “Shitje me kasë kupona – Furra”, në të cilin listohen produktet e shitura për secilin muaj;
- Xhiro ditore e kasës
- Kupona tatimore
- Kupona taimorë “Kasa Prill – Maj – Qershor – Korrik 2021”
- Prinscreen Shitjet sipas artikujve Shtator – Dhjetor 2021

- .....
- Fatura Tatimore Shitje nr.41, datë 31.01.2021; nr.36, datë 31.05.2021; nr.35, datë 31.05.2021; nr.38, datë 30.06.2021; nr.37, datë 30.06.2021;

- .....
- Kontratë nr. prot. 1642/63, datë 26.03.2021, lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Cerdheve dhe Kopshteve dhe operatorit ekonomik “Eraldo – 2013” sh.p.k. me objekt: “Blerje buke thekre dhe integrale”.  
Gjithashtu bashkëlidhur kësaj kontrate operatori ekonomik ankimues ka paraqitur Pasqyrë përmbledhëse e kontratës; Vërtetim realizim kontrate nr. 1777/1 prot., datë 16.12.2021, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Cerdheve dhe Kopshteve, në të cilën konstatohet se Realizimi i vlerës me Tvsh të kontratës deri më datë 14.12.2021; Fatura datë 15.12.2021; 16.12.2021; 17.12.2021, 20.12.2021, 21.12.2021, 22.12.2021, 23.12.2021, 24.12.2021, 28.12.2021, 29.12.2021, 31.12.2021;

III.2.4. Në nenin 14, “Operatorët ekonomikë”, pika 2 e Ligjit nr.162/2020 ”Për prokurimin publik”, parashikohet: *“Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë*

ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.”

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës*

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

III.2.6. Neni 40 “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

**4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

III.2.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e

tenderit dhe ofertat që nuk përputhen me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin “dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Ndërsa kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e furnizimit të marrë përsipër. Në rastin konkret referuar dokumentit kontratë bashkëpunimi, konstatohet se pjesëmarrja e këtyre operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi do të jetë *Shoqëria “Dion – AL’SHPK do të ketë një pjesëmarrje prej 64 % (64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 64 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 64 % të sasisë totale Simite), dhe Shoqëria “Eraldo – 2013” SHPK të ketë një pjesëmarrje prej 36 % (36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 75 %, 36 % të sasisë totale Bukë gruri me rreze 70 %, 36 % të sasisë totale Simite).*

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK dhe “Dion – Al” SHPK, konstatohet se ky bashkim operatorësh ekonomikë nuk përmbush kriterin e përcaktuar për kontrata të ngjashme në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim.

Konkretisht, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK, si një nga operatorët ekonomikë, pjesë e bashkimit, konstatohet se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Fatura Tatimore Shitje për tre vitet 2019 – 2021 me shitës “Dion - AL” sh.p.k. dhe Blerës “Klient shitje me pakicë me kasë” dhe tek Përshkrimi i mallit ose shërbimit përcaktohet “Shitje me pakicë shih bashkëngjitur”. Bashkëlidhur faturave operatori ekonomik “Dion – Al” SHPK ka paraqitur Dokumentin me përmbajtje: Dion –Al shpk; K67917301H; “Pasqyra e shitjeve në njësinë e furrës së bukës (shitje me pakicë me kasë fiskale)”; në të cilën pasqyrohen në tabelë: Nr.; Nr. i serisë së faturës; Data e faturës; Subjekti i cili është përcaktuar “Shitje kase”, Rrethi Tiranë; Totali; Vlera pa tvsh; tvsh.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo – 2013 ” SHPK dhe “Dion – Al” SHPK, në përmbushje të kriterit të mësipërm, KPP konstaton se, faturat tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik “Dion-Al ” SHPK, përshkruajnë shitjen me pakicë në kasë për periudhën 2019 - 2021, duke pasqyruar vlerën, por nuk përshkruhet në mënyrë të detajuar furnizimet e realizuara për të cilat janë lëshuar këto fatura, por referojnë në mënyrë të shprehur në listën bashkëlidhur. Nga verifikimi i listës bashkëlidhur këtyre faturave,

konstatohet se operatori ekonomik 'Dion-Al' SHPK ka paraqitur Dokumentin me përmbajtje: Dion –Al shpk; K67917301H; *“Pasqyra e shitjeve në njësinë e furrës së bukës (shitje me pakicë me kasë fiskale)”*; në të cilën pasqyrohen në tabelë: Nr.; Nr. i serisë së faturës; Data e faturës; Subjekti i cili është përcaktuar “Shitje kase”, Rrethi Tiranë; Totali; Vlera pa tvsh; tvsh, por në asnjë rast nuk pasqyrohen artikujt të cilët janë shitur në këtë njësi. Fakti që, operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK, emërton këtë listë *“Pasqyra e shitjeve në njësinë e furrës së bukës (shitje me pakicë me kasë fiskale)”*, nuk mund të merret e mirëqenë se subjekti “Furrë buke” ka shitur artikullin bukë, i ngjashëm me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka përcaktuar shprehimisht që kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shprehen qartë datat shumë dhe sasi të mallrave të furnizuara, por në rastin konkret operatori ekonomik ankimues në faturat e paraqitura nuk ka pasqyruar në mënyrë të detajuar furnizimet e realizuara, por ka paraqitur *“Pasqyra e shitjeve në njësinë e furrës së bukës (shitje me pakicë me kasë fiskale)”*, në të cilën përsëri nuk pasqyrohen produktet e tregtuara.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Dion – AL” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur disa fatura tatimore në të cilat vërteton se ndër të tjera shitur artikullin bukë, por KPP pasi veçoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit si më sipër cituar vëren se faturat e paraqitura nuk përmbushin vlerën e përcaktuar në dokumentat e tenderit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit.

Sa më sipër, për sa kohë operatori ekonomik ”Dion – AL” SHPK, si një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, nuk përmbush kriterin në lidhje me kontratat e ngjashme në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim, rrjedhimisht kriteri në lidhje me eksperiencën e ngjashme do të konsiderohet i papërmbushur.

Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.2.10. Komisioni rithekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në

përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.11. Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK dhe “Dion – AI” SHPK nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me kontratat e ngjashme, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Sinani Trading” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK dhe “Dion – AI” SHPK, gjykojmë, se referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sinani Trading” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-16646-12-29-2021, me objekt: Loti 1 “*Blerje bukë gruri dhe simite*”, me fond limit 168.101.564 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.02.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eraldo - 2013” SHPK dhe “Dion – AI” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomikë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sinani Trading” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **K KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**